



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9614 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024


“PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/b, pika 1.7/b, neni 54 pika II, me propozim të shoqatës “Labëria, Nderi i Kombit” dega Vlorë, në propozimin e Këshilltarit Z. Myzafer Elezi Zv/Kryetar i Këshillit të Bashkisë të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë në mbledhjen e datës 03.06.2024, si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e një rruge në rajonin nr. 2 në kryqëzim të rrugës Mustafa Bello me emrin “Shyqyri Isuf Llanaj”, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9614 Prot.

Vlorë, më 18.06 2024

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN
MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E
BASHKISË VLORË”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë

Projektvendimi “Për Emërtimim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë” të cilët e paraqesim për miratim lidhet me emrin e të ndjerit Dr. Shyqyri Isuf Llanaj i cili gjatë gjithë jetës së tij si mjek kudo që ka shërbyer ka spikatur për vlerat të larta profesionale dhe vecanërisht humane si njeri. Është për këtë arsye që kudo ku ka ushtruar aktivitetin e vetë si mjek dhe kushdo që ka pasur nderin të komunikojë me të si koleg ose pacient i tij, ka një perceptim dhe vlerësim pozitiv.

Ky vlerësim është reflektuar ndër të tjera në titullin “Qytetar Nderi i Krahinës së Lopsi-t” në Tepelenë, “Mirënjohje e Labërisë” nga shoqata “Labëria”, “Nderi i Kombit”. Gjithashtu është dekoruar me medaljen e Punës nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, Medaljen për Shërbimet të Shquara Shëndetësore nga Presidenti i Republikës Z. Bujar Nishani si dhe vlerësime të tjera nga Institucionet Shetërore.

Këto vlerësime janë rrjedhojë e një karriere tepër mbreslënëse kudo që ka shërbyer për një periudhë 45 vjecare në rrethet e Tepelenës dhe atij të Vlorës. Kjo pasi Z. Shyqyri Isuf Llanaj ka shërbyer në disa pozicione si mjek dhe drejtues i insitucioneve mjekësore si Drejtor Spitali në Sinanaj, Tepelenë, Shef i Seksionit të Shëndetësisë Tepelenë, Inspektor në Drejtorinë e Shendetit Publik Vlorë, mjek i urgjencës në Spitalin Rajonal të Vlorës dhe së fundi Drejtor i Qëndrës Shëndetësore Sevaster ku është edhe vendlindja e tij.

Nisur nga këto vlerësime Shoqata “Labëria” dega Vlorë, si dhe Këshilltari Z. Myzafer Elezi njëkohësisht Zv/Kryetar i Këshillit të Bashkisë kanë propozuar që një rruge në qytet të emërtohet me emrin “Shyqyri Isuf Llanaj”.



Propozimet e sipërcituara janë bërë gjithashtu objekt i shqyrtimit në Komisionin Këshillimor të Titujve Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë i cili në datën 03.06.2024 ka vlerësuar pozitivisht propozimet dhe rekomandon miratimin nga Këshilli i Bashkisë të vendimit për emërtimin e një rruge me emrin e tij referuar dispozitave ligjore në fuqi.

Nga sa më lartë ju propozojmë që të miratoni këtë projektvendim, për emërtimin e rrugës me emrin e Doktor Shyqyri Isuf Llanaj, sipas planvendosjen të përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës si një vlerësim për këtë mjek të shquar, kontributi i të cilit sikurse cituam më lartë është i vlerësuar gjerësisht.

Ju faleminderit

KRYETAR
Ermal Dredha






BASHKIA VLORE

DREJTORIA E
URBANISTIKËS

MIRATOI
KLAUDIO MEHMETAJ



PLANVENDOSJA

RRUGA "SHYQYRI LLANAJ" NË RAJONIN 2, NË KRYQËZIMIN E RRUGËS "MUSTAFA BELLO".

VLORE 2024

A-01